



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:170143

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05875376

KPPP.nr.1250/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “MGM Product”, me NUI:811862219, rr. “Bajram Bytyqi” p.n., Semetisht – Suharekë kundër debitorit “TIJAN COMPANY” SHPK, me NUI:811411701, me seli në fshatin Landovicë komuna e Prizrenit duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.459/23 të datës 14.07.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 25.06.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

I.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “TIJAN COMPANY” SHPK, ashtu që Urdhri P.nr.459/23 i datës 14.07.2023, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin P.nr.459/23 të datës 14.07.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.18/2 e datës 23.03.2022, faturës nr.25 e datës 08.04.2022 dhe faturës nr.38 e datës 22.07.2022 duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimi të urdhrit, t’ia paguajë kreditorit borxhin 1,259.54 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas tarifës së përmbaruesve, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbaresit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se borxhi i kërkuar për përmbarim nuk ekziston dhe se kreditori po tenton t'i vë në lajthitje organet duke tentuar me fatura fiktive të realizoj kërkesa të cilat nuk kanë ekzistuar asnjëherë. Tutje ka shtuar se faturat që paraqiten si titull ekzekutiv nuk mund të kenë efekt juridik. Debitori i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar Prapësimin e debitorit dhe të anuloj në tërësi Urdhrin Përmbarimor P.nr.459/23.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se faturat i janë dorëzuar debitorit dhe i ka pranuar ato (ekziston nënshkrimi i pranimit) si dhe këto fatura janë origjinal. Sipas faturave në propozim borxhi i tërësishëm ishte 2,659.54 Euro, por debitori ka paguar shumën prej 1,400.00 Euro dhe në propozim për përmbarim është kërkuar diferenca e mbetur e pa paguar në vlerë prej 1,259.24 Euro, e që vërtetohet edhe me kartelën financiare të klientit. Kreditori ka kërkuar nga Gjykata që të refuzoj si të pa bazuar prapësimin e debitorit, të vërtetoj Urdhrin Përmbarimor P.nr.459/23 dhe në rast se Gjykata e refuzon të pabazuar prapësimin të detyroj debitorin të deponoj garancinë në Gjykatë në shumën e borxhit 1,259.24 Euro, e nëse nuk e deponon garancinë të mos trajtohet ankesa fare nga Gjykata.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentet e besueshme: faturës nr.18/2 e datës 23.03.2022, faturës nr.25 e datës 08.04.2022 dhe faturës nr.38 e datës 22.07.2022, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimit të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1250/23, me datë 25.06.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.